

# Veprat Penale Kundër të Drejtave të Votimit në Kosovë

Azem Hajdari\*

## Abstrakt

*Veprat penale kundër të drejtës së votimit në Kodin Penal të Republikës së Kosovës janë radhitur në Kapitullin XVIII. Në këtë kapitull ligjvënësi ka parashikuar gjithsej njëmbëdhjetë vepra penale. Përmes këtyre veprave penale mbrohen zgjedhjet e lira, të ligjshme e demokratike. Veprat penale kundër të drejtave të votimit drejtpërdrejt ndikojnë në cilësinë e organeve përfaqësuese, përfshirë cilësinë e qeverisjes, qoftë në nivel qendror apo lokal. Republika e Kosovës ka kohë që përgjatë proceseve zgjedhore po përballet me prezencë relativisht të lartë të këtyre veprave penale. Këtë fakt e dëshmojnë të dhënat e shumta statistikore si dhe raportet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Pasojat e këtyre veprave penale janë të shumta dhe të shumëllojshme, por që kryesisht dominojnë ato të karakterit politik, ekonomik, psikologjik etj. Gjendja e tillë shtron nevojën që në lidhje me këto vepra penale organet përgjegjëse të shtetit (policia, prokuroria dhe gjykatat) të ndërmarrin të gjitha masat ligjore që garantojnë luftë të suksesshme kundër këtij lloji të kriminalitetit. Rrjedhimisht, në trajtimet vijuese do të bëhet fjalë për rëndësinë e mbrojtjes juridike penale e zgjedhjeve të lira dhe sistemit demokratik të zgjedhjeve, për disa nga segmentet kyçe reformuese që ka sjellë Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës në lëmin e të drejtave të votimit, nocionin e veprave penale kundër të drejtave të votimit, vëllimin dhe dinamikën, disa nga karakteristikat personale të kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit, si dhe pasojat dhe masat për luftimin e tyre. Gjatë përgatitjes së këtij artikulli kam përdoruar metodën dogmatike juridike dhe metodën e krahasimit.*

**Fjalët kyçe:** votim, votues, kandidatë, kanosje, keqpërdorim, falsifikim, asgjësim.

## 1 Hyrje

Me veprat penale kundër të drejtave të votimit inkriminohen një tërësi veprimesh apo mosveprimesh kriminale nëpërmjet të cilave cenohet ligjshmëria e procesit elektoral. Këto vepra penale janë në funksion të mbrojtjes së zgjedhjeve të lira e

---

\* Prof. Dr. Mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik.

demokratike si dhe të ligjshmërisë së referendumit. Me Kodin Penal të Republikës së Kosovës janë parashikuar gjithsej njëmbëdhjetë vepra penale kundër të drejtave të votimit. Në kuadër të këtij artikulli të shkurtër fillimisht do të bëhet fjalë për rëndësinë e mbrojtjes juridike penale të zgjedhjeve të lira e demokratike. Kjo për faktin se, në çdo rast kur do të ketë zgjedhje jo demokratike ato do pritet të jenë të kontestuara, të papranuara dhe që degradojnë vlerat shoqërore. Në vazhdim do të flitet për disa prej segmenteve kyçe reformuese që ka sjellë Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës në lëmin e të drejtave të votimit. Këto segmente konsiderohen të një rëndësie të veçantë për faktin se përmes tyre synohet shtimi i efikasitetit në luftimin e këtyre veprave penale. Më tutje do të flitet për nocionin e veprave penale kundër të drejtave të votimit dhe vëllimin e dinamikën e tyre. Në këtë aspekt synohet që lexuesit t'i ofrohet një nocion sa më përgjithësuar i këtyre veprave penale si dhe një pasqyrë tabelare lidhur me shkallën e prezencës së tyre në Kosovë gjatë periudhës 2009 – 2014. Rrjedhimisht, në kuadër të këtij artikulli do të flitet edhe për disa nga karakteristikat personale të kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit dhe pasojat e kryerjes së këtyre veprave penale. Siç do të shihet, shkalla e pranisë së veprave penale kundër të drejtave të votimit manifeston paraqitje relativisht të lartë dhe të larmishme, kurse pasojat e tyre janë të shumta dhe të shumëllojshme. Ndërkaq në fund të këtij artikulli do të flitet për masat për luftimin e tyre, ku theksi do të përqendrohet te masat e karakterit represiv, por pa anashkaluar masat e karakterit parandalues.

## **2 Rëndësia e mbrojtjes juridike penale e zgjedhjeve të lira dhe sistemit demokratik të zgjedhjeve**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e shtetasve për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet përfaqësuese, në bazë të një sistemi demokratik të zgjedhjeve.

Shtetasit e Republikës së Kosovës kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa asnjë lloj diskriminimi dhe në mënyrë të fshehtë vullnetin e tyre në zgjedhje (qendrore apo lokale), të votojnë apo të mos votojnë për kandidatin e regjistruar në listë.

Organeve të përcaktuara shtetërore (Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Policisë, Prokurorisë së Shtetit dhe gjykatave) përmes ligjeve përkatëse u janë lënë detyrime që të sigurojnë realizimin në praktikë të së drejtës së zgjedhjeve të shtetasve dhe t'i mbrojnë subjektet elektorale gjatë fushatës së zgjedhjeve.

Një aspekt i veçantë i mbrojtjes së zgjedhjeve të lira e demokratike është edhe mbrojtja juridike penale, nëpërmjet parashikimit me anë të Kodit Penal të veprave penale që cenojnë ato si dhe të dënimeve përkatëse për to. Ky Kod për veprat penale kundër të drejtave të votimit bën fjalë në kreun e tetëmbëdhjetë të tij. Në këtë rast, përmes këtyre veprave penale dhe dënimeve të parashikuara për to synohet të

sigurohen zgjedhje të lira e demokratike, përkatësisht një sistem zgjedhor demokratik.

### **3 Segmentet kyçe reformuese që ka sjellë Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës në lëmin e të drejtave të votimit**

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, në krahasim me Kodin e Penal të (mëhershëm) të vitit 2004 përmban një numër të konsiderueshëm të zgjidhjeve të reja Shqyrtimi i tërësisë së risive që përmban ky Kod tejkalon suazat e këtij artikulli. Së këndejmi, në vazhdim të kësaj tematike do të flitet vetëm për risitë, përkatësisht segmentet reformuese që Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës i ka bërë në lëmin e të drejtave të votimit, përkatësisht veprave penale kundër të drejtave të votimit. Këto risi e reforma kryesisht kanë të bëjnë me:

1. Ndarjen e këtyre veprave penale dhe radhitjen e tyre në një kapitull të veçantë. Tashmë këto vepra penale janë adresuar në kapitullin XVIII të këtij kodi me emërtimin veprat penale kundër të drejtave të votimit. Kështu nuk ishte më Kodin Penal të vitit 2004. Në atë Kod veprat penale që cenonin të drejtat e zgjedhjeve ishin radhitur në kapitullin e veprave penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut. Me një zgjidhje të tillë ligjvënësi ka dashur t'i japë një peshë dhe cilësi të ri këtyre inkriminimeve bazuar në nevojën që ka në shoqëritë bashkëkohore çështja e zgjedhjeve të lira e demokratike;
2. Shtimin e numrit të veprave penale që janë të drejtuara kundër të drejtave të votimit. Kodi i ri Penal ka parashikuar gjithsej njëmbëdhjetë vepra penale që cenojnë sistemin elektoral, për dallim nga Kodi Penal i vitit 2004 që parashikonte vetëm gjashtë vepra penale të tilla. Konsideroj se ligjvënësi përmes shtimit të numrit të këtyre veprave penale ka dashur të mos lë boshllëk juridik dhe të ndëshkoj çdo veprim apo mosveprim të mundshëm përmes të cilit cenohet procesi i zgjedhjeve dhe referendumeve;
3. Adaptimin e përmbajtjes me emërtimin konkret të veprës penale. Kodi i ri Penal ka shkuar tutje drejt këtij adaptimi. I tillë është rasti me veprën penale të falsifikimit të rezultateve të votimit, për të cilën Kodi i vitit 2004 përdorte emërtimin mashtrimi në votime. Si rrjedhojë, Kodi i ri Penal e lidh më fuqishëm përmbajtjen me emërtimin e veprës (falsifikimi i rezultateve të votimit), dhe kjo është e dukshme në çdo rast kur kihen parasysh veprimet përmes të cilave kryhet kjo vepër; dhe
4. Ashpërsimin e politikës ndëshkimore. Në Kodin e ri Penal, duke marrë në konsideratë faktin se cenimi i sistemit demokratik të zgjedhjeve ishte një dukuri e shpeshtë dhe me shumë pasoja, të thuash gati në të gjitha llojet e veprave penale kundër të drejtave të votimit është shtuar lartësia e dënimit.

Kjo qasje vlerësohet pragmatike, përveç tjerash, edhe për fatin e efekteve që ajo mund të ketë në parandalimin e këtyre veprave penale.

Nuk ka dyshim fakti se risitë dhe reformat e Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës në lidhje me veprat penale kundër të drejtës së votimit kanë përfshirë edhe segmentin që ka të bëjë me zgjerimin e gamës së veprimeve ose mosveprimeve kriminale përmes të cilave kryhen këto vepra penale. Po ashtu, është i padiskutueshëm fakti se risitë dhe reformat që reflekton Kodi i ri Penal në lidhje me veprat penale kundër të drejtave të votimit janë determinuar nga niveli relativisht i lartë i cenimit të sistemit demokratik të zgjedhjeve që u manifestua gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe zgjedhjeve qendrore të vitit 2010.

#### **4 Kuptimi (nacioni) i veprave penale kundër të drejtave të votimit**

Në legjislacionet penale dhe literaturën juridike deri në ditët e sotme nuk është dhënë ndonjë përkufizim i qartë dhe i plotë i nocionit të veprave penale kundër të drejtave të votimit. Kjo për faktin se këto vepra penale në shtetet me demokraci të zhvilluar ose janë krejtësisht të pakta ose mungojnë fare si dhe për faktin se autorët e të drejtës penale me trajtimin shkencor të këtyre veprave penale janë marrë relativisht pak.

Një përkufizim i ri dhe më i qartë i veprave penale kundër të drejtave të votimit së fundmi është bërë sidomos në kodet penale të vendeve të cilat kanë filluar të ballafaqohen më shumë me faktin e cenimit, përkatësisht të shkeljes së të drejtave të votimit, siç është rasti me Kosovën.

Në këtë aspekt, me vepra penale kundër të drejtave të votimit kuptohen ato vepra (veprime e mosveprime) të kundërligjshme që pengojnë realizimin e parimeve kushtetuese e ligjore për zgjedhje të lira e demokratike, të kryera me dashje, dhe me qëllim të caktuar.

Veprimet me të cilat kryhen këto vepra penale konsistojnë në përdorim të forcës, kanosjes, ryshfetit, keqpërdorim të varësisë ekonomike e profesionale e veprime të tjera të paligjshme. Janë këto veprime të cilat mund të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve (për kandidatë ose parti e nisma politike) dhe të cilat e komprometojnë sistemin zgjedhor demokratik.

#### **5 Vëllimi, dinamika dhe shtrirja territoriale e veprave penale kundër të drejtave të votimit**


Vëllimi, dinamika dhe shtrirja territoriale e kriminalitetit në tërësi, përkatësisht e llojit të caktuar të veprave penale përfaqësojnë kategori krimnologjike përmes të cilave synohet të prezantohet niveli dhe lëvizja e dukurive përkatëse kriminale nëpër vite dhe rajone të caktuara të një vendi apo dhe më gjerë. Në përpjekje për të

përmbushur këtë synim, në vazhdim të këtij artikulli, do të flitet për secilën nga këto kategori, natyrisht të ndërlidhura me veprat penale kundër të drejtave të votimit në Kosovë.

### 5.1 Vëllimi i veprave penale kundër të drejtave të votimit

Trajtimi i vëllimit të veprave penale kundër të drejtave të votimit si qëllim të vetin ka prezantimin e nivelit të prezencës së tyre në vend. Natyrisht, prezantimi real i pranisë së këtij lloji të veprave penale, ngjashëm si dhe i formave tjera të kriminalitetit, është një problem sa i ndërlidhur po aq edhe sfidues dhe i pazgjdhshëm. “Kjo ndodh për faktin se vëllimi i saktë i kriminalitetit që paraqitet në shoqëri, pa marrë parasysh evidencimin formal, gati që nuk mund të dihet, sepse ai kurrë nuk evidencohet në tërësi, nuk dihet plotësisht, për shkak të rrethanave të ndryshme që mbretërojnë në shoqëri”.<sup>1</sup> Duke marrë parasysh faktin se edhe te veprat penale kundër të drejtave të votimit janë të pranishme këto rrethana, atëherë edhe shënimet statistikore të cilave u referohemi përkitazi me vëllimin e tyre, duhet shikuar nga ky aspekt me të gjitha rezervat, të cilat rëndom janë të pranishme në kërkimet e këtij lloji.

Pavarësisht kësaj, për qëllimet e këtij hulumtimi, në diagramin vijues do të prezantohen të dhënat lidhur me numrin e kallëzimet penale të ushtruara për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit<sup>2</sup> dhe numrin e personave të dënuar në lidhje me këto vepra penale<sup>3</sup> gjatë periudhës 2009 dhe 2014.



<sup>1</sup> *Krahaso:* Ragip Halili, *Kriminaliteti kundër martesës dhe familjes në KSA të Kosovës* (Prishtinë, 1987) në 84.

<sup>2</sup> *Shih:* Raport statistikor i Policisë së Kosovës lidhur me kallëzimet penale të ushtruara për vitet 2009 – 2014.


<sup>3</sup> *Shih:* Raportet statistikore (periodike dhe vjetore) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve gjyqësore për periudhën 2009 – 2014.

Sipas këtyre të dhënave gjatë periudhës 2009 – 2014 në Republikën e Kosovës për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit janë dënuar 206 persona. Ky numër i personave të dënuar duket simbolik në krahasim me numrin prej 1619 personave ndaj të cilëve janë ushtruar kallëzime penale, e sidomos nivelin e perceptimit të opinionit publik që ekziston përkitazi me shkallën e lartë të manipulimit të votës gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe atyre qendrore të vitit 2010.

## 5.2 Dinamika e veprave penale kundër të drejtave të votimit

Po ashtu, në kontekst të manifestimit nëpër vite, do të pasqyrohet niveli i pranisë së veprave penale kundër të drejtave të votimit në Kosovë gjatë viteve 2009 – 2014. Bazament mbështetës i këtij pasqyrimi do të jetë numri i personave të dënuar për kryerje të këtyre veprave penale.

Në fakt, në diagramin vijues do të prezantohen të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi numrin e personave të dënuar për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit nga gjykatat e Republikës së Kosovës sipas rrjedhës kronologjike të zgjedhjeve të zhvilluara gjatë periudhës 2009 – 2014.



Sipas këtyre të dhënave numri më i madh i personave (190 kryerës) për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit është dënuar në lidhje me veprimet kriminale të kryera gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe zgjedhjeve qendrore të vitit 2010. Këto të dhëna dëshmojnë se për zgjedhjet lokale të vitit 2009 janë dënuar 54 persona, për zgjedhjet qendrore të vitit 2010, 136 persona, për zgjedhjet lokale të vitit 2013 janë dënuar 16 persona, kurse për zgjedhjet qendrore të vitit 2014 (me

gjasë për arsye procedurale) nuk është dënuar asnjë person. Numrin më të lartë të veprave penale kundër të drejtave të votimit të kryera gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe atyre qendrore të vitit 2010 duhet ndërlidhur gjithsesi me mungesën e përvojës në lidhje me zgjedhjet që i ka karakterizuar organet e vendit përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, por edhe me ambiciet që kanë shprehur forcat politike për të marrë për sipër benifitet e pushtetit dhe meritat e shtet formimit të vendit. Ndërkaq, numri shumëfish më i vogël i personave të dënuar për zgjedhjet e zhvilluara lokale të vitit 2013 dhe zgjedhjet qendrore të vitit 2014 mund të shpjegohet me presionin e madh ndërkombëtar të shprehur në lidhje me këto zgjedhje dhe nivelin e lartë të përkushtimit të policisë dhe prokurorisë së shtetit që në këto zgjedhje të përmbushin misionin e përcaktuar me ligj për të siguruar ndëshkim të krimit dhe zgjedhje të lira e demokratike.

### 5.3 Shtrirja territoriale e veprave penale kundër të drejtave të votimit

Përmes shtrirjes territoriale si komponentë kriminologjike synohet të pasqyrohen të dhënat lidhur me nivelin e prezencës së veprave penale kundër të drejtave të votimit nëpër rajonet përkatëse të Kosovës. Edhe në kuadër të këtij trajtimi do të përdoren të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës përkitazi me numrin e personave të dënuar për kryerje të këtyre veprave penale.

Rrjedhimisht, në tabelën vijuese do të prezantohen të dhënat lidhur me numrin e personave të dënuar për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit nëpër gjashtë rajonet e Kosovës gjatë periudhës 2009 – 2014.

Rajonet	Numri i personave të dënuar
Prishtinë	97
Gjilan	14
Ferizaj	23
Gjakovë	09
Mitrovicë	12
Prizren	21
Pejë	24
Gjithsej	209 <sup>4</sup>

Sipas këtyre të dhënave numri më i madh i personave të dënuar për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit vijnë nga Rajoni i Prishtinës. Të tillë janë 97 persona, pastaj vjen Peja me 24, Ferizaj me 23, Prizreni me 21 e kështu me

<sup>4</sup> *Shih*: Raportet statistikore (periodike dhe vjetore) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve gjyqësore për periudhën 2009 – 2014.

radhë. Shkakun e pjesëmarrjes kaq të lartë të kryerësve nga Rajoni i Prishtinës në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit duhet lidhur gjithsesi me ambiciet që kanë subjektet politike për të zgjeruar shkallën e ndikimit në Kryeqytet, por edhe me faktin lëvizjeve demografike e kulturore që e kanë përcjellë këtë rajon në periudhën e pasluftës.

## **6 Disa nga pasojat e veprave penale kundër të drejtave të votimit**

Veprat penale kundër të drejtave të votimit shkaktojnë pasoja të shumta dhe të llojllojshme. Pasoja që i shkaktojnë këto vepra penale, marrë në përgjithësi mund të jenë të natyrës politike, psikologjike, ekonomike etj.

Realitetet e jetës bashkëkohore dëshmojnë se përmes kryerjes së veprave penale kundër të drejtave të votimit ndikohet efektshëm në rrjedhat e jetës politike. Kjo për faktin se përmes kryerjes së këtyre veprave penale ndikohet drejtpërdrejt në cilësinë e qeverisjes, bazuar në faktin se ato përcaktojnë forcën politike dhe personat brenda saj që do të qeverisin me vendin. Kjo për faktin se personat që vijnë në pushtet përmes manipulimit të votës zakonisht nuk ndiejnë përgjegjësi për mënyrën se si do ta qeverisin vendin apo komunën e tyre. Tashmë dihet botërisht se “prezenca në nivele të larta të këtyre veprave penale pengon reformat politike e institucionale, shkakton pengesa e vështirësi në integrimin e vendit në organizata e institucione ndërkombëtare, antipati ndaj shtetit të tillë “problematikë” etj. Pasoja e tilla tashmë i kanë ndier mbi kurrizin e tyre qytetarët e Kosovës. Në fakt, veprat penale kundër të drejtave të votimit, sidomos kur në kryerjen e tyre përfshihen personat që ushtrojnë funksione të larta publike, shkaktojnë edhe humbje të shpresës së qytetarëve lidhur me perspektivën e vendit të tyre’.<sup>5</sup>

Përveç pasojave politike veprat penale kundër të drejtave të votimit shkaktojnë edhe pasoja psikologjike. Fakti se kryerja e këtyre veprave penale nxitet e stimulohet nga persona me ndikim në jetën politike dhe institucionale, se ata nuk kanë qenë në asnjë rast në proces të ndjekjes e gjykimi për to, si dhe fakti se kryerësit e tyre edhe kur ndiqen e gjykohen marrin dënime minimale, ndikon te një pjesë e opinionit publik që të krijohet përshtypja se ky kriminalitet është i pamposhtur. Rastet, të thuash simbolike, të ndjekjeve dhe gjykimeve të personave për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit lidhur me zgjedhjet lokale të vitit 2009 dhe atyre qendrore të vitit 2010 ku pati abuzim flagrant të votës së qytetarëve dhe dënimi i vetëm 206 personave, si dhe duke lënë anash ndëshkimin e shtytësve të tyre (kandidatëve për deputetë e kryetar komunash, personave të politikës etj.) janë faktorë që ushtrojnë efekt të drejtpërdrejtë psikologjik në kategori e grupe të ndryshme të qytetarëve. Kjo ndikon në shkallën e ultë të pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje e procese tjera politike, e deri te ato

<sup>5</sup> Ibid, në 57.



që te disa individ mund të nxisë motive që edhe ata të praktikojnë të njëjtën gjë në mënyrë që të fitohet apo ndërrohet pushteti në favor të subjektit politik të caktuar.

Veprat penale kundër të drejtave të votimit reflektojnë ndikime edhe të natyrës ekonomike. Këto vepra penale, duke qenë të lidhura me interesa nga më të ndryshmet, në një mënyrë ose tjetër atakojnë bizneset, sepse në shumë raste kryerësit e tyre u kërkojnë atyre mbështetje financiare gjatë fushatave zgjedhore; pengojnë investimet e investitorëve potencialë lokalë e ndërkombëtar, sepse zakonisht klasa politike që merr qeverisjen përmes zgjedhjeve të manipuluar edhe përfaqëson klasë të prirur për korrupsion; dhe dëmtojnë buxhetin e shtetit etj.; bazuar në faktin se në çdo rast të ndërrimit të pushteteve komunale apo atyre qendrore pushtetet e fituara dhe auditimet e brendshme të zhvilluara kanë nxjerrë në dritë keqpërdorime të mëdha të parasë publike.<sup>6</sup>

Për shkallën e lartë të manipulimeve të proceseve zgjedhore në Kosovë dhe pasojat e tyre për vendin kanë tërhequr vërejtjen edhe raportet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, por edhe ato të shoqërisë civile të vendit. Që të gjitha ato kanë vë në dukje nevojën për reformim të sistemit zgjedhor dhe ndryshim të qasjes ndaj mënyrës së fitimit apo ruajtjes së pushtetit, në mënyrë që vendit t'i hapen perspektivat zhvillimore dhe integruese. Fatkeqësisht këto kërkesa në kalkulimet politike të vendit mbeten pa ndonjë rezultat substancial, përkundër faktit se trysnia ndërkombëtare ushtroi ndikimin e saj në uljen e nivelit të kryerjes së veprave penale kundër të drejtave të votimit gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013 dhe atyre qendrore të vitit 2014.

Përballë kësaj gjendje, është detyrë ligjore e aktorëve kryesorë institucional që të ndërmarrin çdo masë të lejuar me ligj dhe kështu të marrin mbi vete përgjegjësinë që kanë për luftimin e çdo lloji krimi, përfshirë krimin elektorale, në mënyrë që vendit një herë e mirë t'i kthehet perspektiva.

## **7 Disa karakteristika personale të kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit**

Kriminaliteti në tërësi, së këndejmi edhe disa lloje të kriminalitetit në veçanti, nuk mund të shpjegohen në tërë kompleksitetin e tyre pa u studiuar dhe ndriçuar edhe disa karakteristika themelore personale dhe sociale të këtyre sjelljeve, nga se kriminaliteti si dukuri e përgjithshme manifestohet përmes kryerjes së veprave penale konkrete.<sup>7</sup>

---

<sup>6</sup> Në të gjitha këto raste janë raportuar shpenzime të mëdha të mjeteve monetare nga linja e shpenzimeve të mallrave e shërbimeve, të cilat ndërlidhen me ushqimin dhe udhëtimet zyrtare, duke mos lënë anash edhe ndërrimin e destinimit të shpenzimeve kapitale.

<sup>7</sup> Mihajlo Ačimović, *Pravci Kriminalne Psihologije*, (Beograd, 1976) në 7 – 8.

Duke pasur parasysh këtë fakt, në trajtimet vijuese shkurtimisht do të bëhet fjalë për moshën, gjininë, nivelin arsimor dhe përkatësinë sociale të kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit.

### 7.1 Moshë e kryerësit

Moshë është një karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal që ka peshë të veçantë në shpjegimin e sjelljeve kriminale.<sup>8</sup> Të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore, si dhe të dhënat e kërkimeve kriminologjike dëshmojnë se kryerësit u takojnë personave të moshave të ndryshme. Ky fakt është prezent te të gjitha veprat penale, e kështu edhe te veprat penale kundër të drejtave të votimit. Rezultatet e këtij artikulli dëshmojnë se kryerësit e veprave penale kundër të drejtave të votimit, kryesisht janë persona të rritur.

Në tabelën vijuese do të prezantohet moshë e personave të dënuar për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit gjatë periudhës 2009 – 2014.

Moshë e personave të dënuar	Numri i personave të dënuar
14 – 18	3
18 – 28	89
28 – 38	66
38 – 48	37
48 – 58	11
58 e më lartë	00
	206 <sup>9</sup>

Sipas këtyre të dhënave veprat penale kundër të drejtave të votimit në masën më të madhe janë kryer nga personat e moshave ndërmjet 18 – 28 vjeçare dhe atë në 89 raste, pastaj vijnë personat që u përkasin moshave ndërmjet 28 e 38 vjeçare me 66 raste, personat e moshave 38 – 48 me 37 raste e kështu me radhë. Kryerja e numrit më të madh të veprave penale kundër të drejtave të votimit nga personat e moshave të përmendura shpjegohet me faktin se janë personat e këtyre moshave që më së tepërmi janë angazhuar në detyra zyrtare gjatë zgjedhjeve. Prandaj, ky grup i personave ka ardhur në situatë që më shpesh të kryej këto vepra penale.

### 7.2 Gjinia e kryerësit

Po ashtu edhe gjinia, ngjashëm si dhe moshë, paraqet karakteristikë të rëndësishme të fenomenit kriminal, që ka rëndësi të caktuar në shpjegimin e sjelljeve kriminale.

<sup>8</sup> Ragip Halili, *Kriminologjia*, (Prishtinë, 2000) në 76.

<sup>9</sup> *Shih*: Raportet statistikore (periodike dhe vjetore) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve gjyqësore për periudhën 2009 – 2014.

Ekziston një përshtypje e përgjithshme se kriminaliteti është dukuri tipike e gjinisë mashkullore.<sup>10</sup> Hulumtimet e shumta të zhvilluara për forma të ndryshme të krimeve në shumë vende të botës dëshmojnë këtë fakt. Kjo tendencë vërehet edhe në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Të dhënat lidhur me personat e dënuar për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit dëshmojnë se si subjekt të këtyre veprave paraqiten kryesisht meshkujt.

Në tabelën vijuese do të pasqyrohet gjinia e personave të dënuar për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit gjatë periudhës 2009 – 2014.

Gjinia e personave të dënuar	Numri i personave të dënuar
Meshkuj	203
Femra	3
Gjithsej	206 <sup>11</sup>

Pjesëmarrjen kaq të lartë të meshkujve në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit duhet shpjeguar me faktin se kanë qenë meshkujt ata që mbi 95% të rasteve janë angazhuar si komisioner të qendrave të votimit. Rrjedhimisht, fakti i shkallës së tillë të pjesëmarrjes së femrës në kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit ndërlidhet me angazhimin akoma të pamjaftueshëm të femrës në pozita të komisionereve dhe pozita të tjera zyrtare që ndërlidhen me zgjedhjet.

### 7.3 Niveli arsimor i kryerësit

Kërkimet e shumta kriminologjike e konsiderojnë arsimimin si faktor të rëndësishëm në pengimin e kriminalitetit. Ky fakt është provuar edhe në rezultatet modeste të këtij artikulli.

Se cila është shkalla e pjesëmarrjes së personave të dënuar në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit gjatë periudhës 2009 – 2014 bazuar në nivelin arsimor të kryerësve më së miri provohet nga të dhënat që do të pasqyrohen në tabelën vijuese.

Niveli arsimor i personave të dënuar	Numri i personave të dënuar
Pa shkollim të kryer fillor	13
Me shkollim fillor	39
Me shkollim të mesëm	154
Me fakultet	00

<sup>10</sup> Ragip Halili, *Kriminologjia*, në 77.

<sup>11</sup> *Shih*: Raportet statistikore (periodike dhe vjetore) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve gjyqësore për periudhën 2009 – 2014.

Gjithsej	206 <sup>12</sup>
----------	-------------------

Sipas këtyre të dhënave numri më i madh i personave të dënuar për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit u përket personave me shkollë të mesme. Këta persona marrin pjesë në kryerjen e këtyre veprave penale me 154 raste, pastaj vijnë personat me shkollim fillor me 39 raste dhe personat pa arsimim fillor (vetëm me disa klasë të fillores së kryer) me 13 raste. Shkallën e pjesëmarrjes më të lartë të personave me shkollë të mesme në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit po ashtu duhet kërkuar në nivelin e angazhimit të tyre si komisioner pranë qendrave të votimit, por pa përjashtuar faktorët tjerë ndikues, siç mund të jenë ata që ndërlidhen me manipulimin e këtyre personave të cilët zakonisht janë persona që veten e shohin të humbur në tregun e punës dhe dijes.

#### 7.4 Gjendja sociale e kryerësit

Të dhënat e shumta nga praktika gjyqësore dhe hulumtimet nga kërkimet kriminologjike dëshmojnë se numri më i madh i kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit rrjedhin nga personat e papunësuar dhe me gjendje të vështirë ekonomike. Ky fakt është provuar edhe në rezultatet modeste të këtij artikulli.

Në tabelën vijuese do të prezantohen të dhënat mbi përkatësinë sociale të personave të dënuar për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit gjatë periudhës 2009 – 2014.

Përkatësia sociale e personave të dënuar	Numri i personave të dënuar
Të punësuar	33
Të papunësuar	173
Gjithsej	206 <sup>13</sup>

Sipas këtyre të dhënave prej 206 personave të dënuar 173 kanë qenë persona të papunë. Kryerja e numrit kaq të lartë të veprave penale kundër të drejtave të votimit nga personat e papunë shpjegohet me gjendjen e rëndë ekonomike në të cilën ndodhet vendi dhe me pa perspektivën e qytetarëve lidhur me punësimin e tyre. Konsiderohet se shumica e këtyre personave janë përfshirë në kryerjen e këtyre veprave penale mbështetur në premtimet e bëra publike apo edhe individuale për punësim të tyre pas fitores në zgjedhje që ua kanë bërë persona me

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> *Shih*: Raportet statistikore (periodike dhe vjetore) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve gjyqësore për periudhën 2009 – 2014.

ndikim në jetën publike të vendit. Mbi bazën e këtij fakti mund të konkludohet se me rritjen e punësimit dhe mirëqenies së qytetarëve do të vihet gjithsesi në zvogëlimin edhe të rasteve të kryerjes së këtyre veprave.

## **8 Masat për luftimin e veprave penale kundër të drejtave të votimit**

Për parandalimin dhe luftimin e veprave penale kundër të drejtave të votimit si dhe të kriminalitetit në përgjithësi gjatë zhvillimit historik të shoqërisë njerëzore janë përdorur mjete e metoda të ndryshme. Të gjitha masat që përdoren për luftimin e veprave penale kundër të drejtave të votimit mund të ndahen në: masa preventive dhe masa represive.

### **8.1 Masat preventive**

Me fjalën masa preventive kuptohet tërësia e veprimeve të cilat ndërmerren nga një rreth i gjerë i subjekteve shtetërore dhe qëllimi i tyre është pengimi i shfaqjes së kriminalitetit si dukuri socio-patologjike, nëpërmjet eliminimit dhe luftimit të shkaqeve dhe kushteve që determinojnë atë.<sup>14</sup> Masat preventive që ndërmerren për të penguar kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit mund të jenë të shumta dhe të llojllojshme. Masat e tilla mund të jenë të karakterit të përgjithshëm dhe konkret.

Masat e karakterit të përgjithshëm kanë të bëjnë me avancim të pozitës sociale dhe të mirëqenies së popullsisë, ngritje të nivelit arsimor dhe kulturor, ekuilibrim dhe stabilizim të rrethanave shoqërore politike, ndryshimit të mjedisit shoqëror dhe humanizimin e tij, forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor etj.<sup>15</sup>

Ndërsa masat e karakterit të posaçëm nënkuptohen masat të cilat i ndërmarrin organet e gjyqësorit dhe subjektet tjera shtetërore e shoqërore të bashkësisë së caktuar. Këto masa sa i përket veprave penale kundër të drejtave të votimit do duhej fokusuar në:

1. Nxjerrjen e legjislacionit përkatës;
2. Themelimi i mekanizmave të përgjegjshëm e efektiv kundër veprave penale kundër të drejtave të votimit;
3. Ushtrimin e efikas të përgjegjësive nga ana e policisë, prokurorisë së shtetit dhe gjykatave me qëllim zbulimi, ndjekje, arrestimi e dënimi të kryerësve të këtyre veprave penale;
4. Organizimin e mirë të punës në çështjet e sigurisë dhe risocializimit të personave të burgosur në institucionet penitenciare, me qëllim të evitimit të rasteve të recidivit;

---

<sup>14</sup> Milan Milutinoviç, *Politika kriminale*, (Prishtinë, 1987) në 388.

<sup>15</sup> Ibid, në 381.

5. Avancimin e nivelit të bashkëpunimit ndërkombëtar midis policisë, prokurorit të shtetit dhe gjykatave të Kosovës me shtetet tjera dhe institucione të specializuara për luftimin e krimit (Interpolit dhe Evropolit);
6. Realizimin e reformave të thella në sistemin zgjedhor. Këtu mendohet në radhë të parë në nxjerrjen e një legjislacioni që do të mbyllte shtigjet e manipulimit të votave;
7. Futjen e metodave të reja të votimit, siç mund të ishte ai i votimit elektronik etj.

Është evidente se zbatimi i këtyre dhe masave të tjera të kësaj natyre në Kosovë ka shënuar performancë jo të mirë gjatë këtyre viteve të tranzicionit. Në këtë aspekt, vlerësohet se ndërmarrja e masave të tilla është garancia më e mirë e luftimit afatgjatë të veprave penale kundër të drejtave të votimit.

### **8.3 Masat represive**

Represioni është forma tjetër e reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit. Ajo punë u është besuar kryesisht organeve dhe organizatave të specializuara, e në radhë të parë atyre shtetërore (policisë, prokurorive gjykatave, organeve të ekzekutimit të dënimeve etj.). Masat represive janë të parashikuara me ligj dhe si të tilla kanë për qëllim mbrojtjen e jetës dhe vlerave tjera të njeriut dhe shoqërisë nga veprimet kriminale.<sup>16</sup>

Masat represive të cilat përdoren për luftimin e veprave penale kundër të drejtave të votimit mund të jenë të dyllotja: politika e zbulimit dhe ndjekjes penale të kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit si dhe politika e aplikimit të sanksioneve penale ndaj kryerësve të tyre.

#### **8.3.1 Politika e zbulimit dhe të ndjekjes penale të kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit**

Zbulimi i veprave penale kundër të drejtave të votimit dhe i kryerësve të tyre ka rëndësi të posaçme në luftimin e kësaj forme të kriminalitetit. Zbulimi i këtyre veprave ka rëndësi të madhe edhe në zvogëlimin e numrit të errët të tyre. Konsiderohet se deri më tash në Kosovë nuk është bërë sa duhet në luftimin e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Arsyet për këtë janë të shumta dhe të llojllojshme. 'Ato para së gjithash kanë të bëjnë me zbulimin e rrethanave të kryerjes së këtyre veprave penale, të kryerësve të tyre,<sup>17</sup> por më së tepërmi me

<sup>16</sup> *Krahaso: Azem Hajdari, Veprat Penale me Natyrë Korrupsioni me një vështrim të Posaçëm në Kosovë*, (Prishtinë, 2003) në 124 – 125.

<sup>17</sup> *Krahaso: Azem Hajdari, Krimet e Luftës kundër Popullsisë Civile në Kosovë gjatë Periudhës Shkurt 1998 – Qershor 1999*, (Prishtinë, 2002) në 252.

trajtimin joadekuat që organet kompetente i bëjnë veprave penale kundër të drejtave të votimit (neglizhenca në luftim).<sup>18</sup>

Përveç zbulimit dhe evidentimit të veprave penale kundër të drejtave të votimit çështje kyçe që drejtësia të triumfojë përballë krimit është zbulimi dhe nxjerrja para drejtësisë e kryerësve të tyre. Rezultatet e këtij artikulli provojnë se në këtë aspekt, përkundër rezultateve të shënuara, në punën e policisë dhe prokurorisë manifestohen mangësi të theksuara. Këto mangësi manifestohen përgjithësisht, por sidomos në hetimin e zyrtarëve të lartë publikë kur ata janë të përfshirë në kryerje të këtyre veprave penale. “Kështu, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës për periudhën 2009 – 2014 janë ngritur 1619 kallëzime penale përkitazi me veprat penale kundër të drejtave të votimit.<sup>19</sup> Në mesin e këtyre hetimeve nuk është përfshirë asnjë rast i vetëm i ndonjë zyrtari të lartë politik e shtetëror të Kosovës, pavarësisht faktit se një numër sish kanë nxitur e stimuluar kryerjen e tyre.

Pas zbulimit të kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit, që lufta kundër kësaj forme të krimit të arrijë efektet e dëshiruara është e domosdoshme që ata të ndiqen penalisht dhe arrestohen. Rezultatet e këtij artikulli dëshmojnë se gjatë periudhës 2009 – 2014 për vepra penale kundër të drejtave të votimit janë arrestuar 437 persona, nga të cilët 377 janë liruar pas kalimit të afatit prej 48 orësh të arrestimit të tyre.<sup>20</sup> Po ashtu, sipas të dhënave të Prokurorisë së Shtetit për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit gjatë periudhës së zbatimit të këtij hulumtimi janë ngritur 583 aktakuza.<sup>21</sup>

Që të realizohet një luftë më e suksesshme ndaj veprave penale kundër të drejtave të votimit kërkohet një angazhim i avancuar i organeve të autorizuara për luftimin e krimit (policisë, prokurorisë së shtetit, gjykatave etj.) depolitizim në punën e këtyre organeve, bashkëpunim dhe punë ekipore e profesionale të cilat në çështjet që kanë të bëjnë me luftimin e kësaj forme të krimit janë më se të domosdoshme.

### **8.3.2 Politika e aplikimit të dënimeve ndaj kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit**

Luftimit të suksesshëm të veprave penale kundër të drejtave të votimit mund t'i kontribuohet në masë të konsiderueshëm, duke zbatuar politikë ndëshkuese adekuate në fushën e aplikimit të sanksioneve penale. “Në këtë aspekt, roli kryesor u takon dënimeve të cilat u shqiptohen kryerësve të veprave penale gjatë

<sup>18</sup> Azem Hajdari, *Veprat penale me Natyrë Korrupsioni*, në 127.

<sup>19</sup> Sipas studimit të bërë nga KIPRED lidhur me ndjekjet penale dhe gjykimet e krimeve të zgjedhjeve në Kosovë vetëm lidhur me zgjedhjet qendrore të vitit 2010 janë ngritur 1217 kallëzime penale.

<sup>20</sup> *Shih*: Evidencat statistikore të Policisë mbi kallëzimet penale të ushtruara për vitet 2008 – 2013.

<sup>21</sup> *Shih*: Evidencat statistikore të Prokurorit të Shtetit mbi aktakuzat e ngritura për vitet 2009 – 2014.

procedurës penale.”<sup>22</sup> Në këtë rast, mendohet në dënime adekuate, të atilla që i përgjigjen shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe kryerësit të saj.

Rezultatet modeste të këtij artikulli provojnë se gjatë periudhës 2009 – 2014 gjykatat kanë dënuar me burgim 113 persona, të cilët janë dënuar mesatarisht me 7 muaj e 15 ditë burgim; dënim me gjobë 34 persona; dënim me kusht 52 dhe dënime të tjera 7 persona. Vlen të theksohet fakti se gjatë kësaj periudhe kohore ka ardhur deri te parashkrimi i 58 rasteve për të cilat është ngritur aktakuzë.<sup>23</sup>

Këto të dhëna dëshmojnë se gjykatat e Kosovës ndaj kryerësve të veprave penale kundër të drejtave të votimit kanë aplikuar politikë ndëshkuese relativisht të butë si dhe në punën e tyre është vërejtur një neglizhencë e theksuar pune.

Duke pasur parasysh shkallën relativisht të lartë të prezencës së veprave penale kundër të drejtave të votimit në Kosovë, e sidomos pasojat e mëdha që kjo formë e kriminalitetit po i shkakton vendit sidomos në aspektin politik, ekonomik e integrues konsideroj se gjykatat është dashur që maksimalisht ta ashpërsojnë politikën e ndëshkimeve si dhe që lëndëve me natyrë elektorale t’u jepet prioritet i niveleve të larta, jo vetëm nëpërmjet deklaratave, por edhe në mënyrë thelbësore.

## 9 Përfundime

Rezultatet e këtij artikulli sjellin në këto përfundime:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton zgjedhje të drejta dhe demokratike. Në këtë aspekt, ky akt juridik përcakton të drejtën e shtetasve për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet përfaqësuese, në bazë të një sistemi demokratik të zgjedhjeve.

Një aspekt i veçantë i mbrojtjes së zgjedhjeve të lira është edhe mbrojtja juridike penale, nëpërmjet parashikimit në Kodin Penal të veprave penale që cenojnë ato si dhe të dënimeve përkatëse për to.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka parashikuar njëmbëdhjetë vepra penale kundër të drejtave të votimit. Përmes këtyre veprave penale ligjvënësi ka inkriminuar, të thuash, të gjitha veprimet e mosveprimet e kundërligjshme përmes të cilave kryhen këto vepra penale.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i vitit 2013 në lidhje me veprat penale kundër të drejtave të votimit përmban një sërë risish në krahasim me Kodin Penal të vitit 2004. Këto risi kanë të bëjnë me faktin se këto vepra penale ky kod i radhit në një kapitull të veçantë, pastaj se ky kod ka shtuar numrin e këtij lloji të veprave penale, ka bërë ashpërsim të politikës ndëshkimore etj.

<sup>22</sup> Milan Milutinović, *Politika kriminale*, në 258.

<sup>23</sup> *Shih*: Raportet statistikore (periodike dhe vjetore) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve gjyqësore për periudhën 2009 – 2014.



Sipas të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë periudhës 2009 – 2014 në Republikën e Kosovës për kryerje të veprave penale kundër të drejtave të votimit janë dënuar 206 persona. Ky numër i personave të dënuar duket simbolik në krahasim me numrin prej 1619 personave ndaj të cilëve janë ushtruar kallëzime penale, e sidomos nivelin e perceptimit të opinionit publik që ekziston përkitazi me shkallën e lartë të manipulimit të votës gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe atyre qendrore të vitit 2010.

Sipas të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës veprat penale kundër të drejtave të votimit gjatë periudhës 2009 – 2014 kanë shënuar shtrirje në tërë territorin e Kosovës. Pavarësisht kësaj, të dhënat për personat e dënuar (206 të tillë) dëshmojnë se numri më i madh i të dënuarve për kryerje të këtyre veprave penale vijnë nga Rajoni i Prishtinës 97 persona, pastaj vjen Peja me 24, Ferizaj me 23, Prizreni me 21 e kështu me radhë. Shkakun e pjesëmarrjes më të lartë të Rajonit të Prishtinës në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit duhet lidhur gjithsesi me ambiciet që kanë subjektet politike për të zgjeruar shkallën e ndikimit në Kryeqytet, por edhe me faktin lëvizjeve demografike e kulturore që e kanë përcjellë këtë rajon në periudhën e pasluftës.

Veprat penale kundër të drejtave të votimit shkaktojnë pasoja të shumta. Ato dëmtojnë imazhin e shtetit në planin ndërkombëtar, dëmtojnë mënyrën e funksionimit të shtetit si dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Në parandalimin e veprave penale kundër të drejtave të votimit rëndësi të veçantë ka konsolidimi i demokracisë dhe shtetit ligjor si dhe depolitizimi i organeve të judikaturës (policisë, prokurorive e gjykatave). Që kjo të ndodhë është e domosdoshme që këto organe të shtojnë efikasitetin e punës së tyre në luftimin e krimit.

Në luftimin dhe parandalimin e veprave penale kundër të drejtave të votimit roli i legjislacionit penal është i një rëndësie të madhe, nga se me inkriminimin e sjelljeve të rrezikshme, ndikohet në mënyrë preventive ndaj qytetarëve që të rezervohen nga kryerja e veprave penale, dhe përkrahim domosdonë që ai të jetë sa më efikas dhe i zbatueshëm, në mënyrë që tu ofrojë mundësi të gjera veprimi organeve të judikaturës penale.

Në luftimin e veprave penale kundër të drejtave të votimit rëndësi të madhe politika ndëshkimore adekuate. Kjo politikë në Kosovë është vlerësuar e butë dhe e pamjaftueshme që ta luftoj efektshëm këtë formë të kriminalitetit. Së këndejmi, konsideroj se një ashpërsim i politikës ndëshkimore mund të jetë një kontribut i rëndësishëm në zvogëlimin e veprave penale kundër të drejtave të votimit.